



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1554/prot.

Tiranë, më 21.10.2020

11

VENDIM

Nr. 20, datë 21.10.2020

**“Për miratimin e rregullore së brendshme të Universitetit të Tiranës  
për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi COVID-19”**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 3, 38 dhe 40; Statutin e Universitetit të Tiranës nenet 6, 31 dhe 36, gërma “k”; Urdhri i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 5229, datë 30.09.2020 “Mbi fillimin e vitit akademik 2020-2021 dhe masat që duhet të marrin institucionet e arsimit të lartë”; Urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 289, datë 04.05.2020, “Për miratimin e udhëzuesit për masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore”, Udhëzuesin e Institutit të Shëndetit Publik nr. 1163/1 prot, datë 13.10.2020 “Mbi përdorimin e detyrueshëm të maskave në ambientet jashtë shtëpisë”, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 21.10.2020;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Rregulloren e Brendshme të Universitetit të Tiranës “Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi COVID-19”.
2. Ky vendim i përcillet për zbatim të gjitha njësive përbërëse të Universitetit të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Prof. Dr. Artan Hoxha

